

VENDIM
Nr.707, datë 16.7.2008

MBI VLEFISHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT “TV KABLLOR DCN”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Frano Kulli	Zvendëskryetar
Artan Zeneli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Gent Ibrahim	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekti: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “TV kabllor DCN”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr.576, datë 27.4.2007 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizivë privatë”,

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.256, datë 31.8.2004, ka licencuar shoqërinë “Digital Cable Network” sh.a., për televizionin privat kabllor “DCN”, me nr.licence 012/RTVK, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës.

Me vendimin nr.576, datë 27.4.2007 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizivë privatë”, KKRT, paraprakisht vendosi të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit “TV kabllor DCN”, pasi nuk kishte shlyer pagesën vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet radiotelevizive.

Sipas pikës dy të vendimit të sipërcituar, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim, por deri më tani, KKRT vëren se, subjekti “TV kabllor DCN” nuk ka depozituar asnjë pretendim lidhur me vendimin në fjalë.

KKRT konstaton se subjekti “TV kabllor DCN” nuk ka shlyer detyrimet financiare të pagesave vjetore për licencë, respektivisht për vitet 2005, 2006 dhe 2007 dhe se në bazë të nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, KKRT ka të drejtë të bëjë të pavlefshme licencën “...kur kërkuar nuk e tërheq licencën ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr.576, datë 27.4.2007 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizivë privatë”,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën subjektit televiziv privat kabllor “TV DCN”.

2. Licenca nr.012/RTVK bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti “TV kabllor DCN” detyrohet të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)